



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis

Të dhënat themelore për programin e studimit : “MENAXHIM NË TURIZËM DHE
HOTELERI” (BSC)

Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit:	Programi i studimit është në linjë me misionin e institucionit të arsimit të lartë dhe qëllimet strategjike, nevojat e shoqërisë dhe është në dispozicion për publikun. Programi i studimeve Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Hoteleri" është një program i studimeve themelore që ofron edukim shkencor dhe të avancuar në këtë fushë të rëndësishme të studimit i cili është hartuar konform Ligjit të Arsimit të Lartë 04/L-037, në Republikën e Kosovë, Udhëzimit Administrativ (MASHT) 09/2019 (Aneksi 8), sipas deklaratës së Bolonjës, Statutit të Universitetit “Haxhi Zeka”, Rregulloren për programet e studimit, të Universitetit “Haxhi Zeka” (Aneksi 9), Rregulloren për studimet themelore bachelor shkencor dhe bachelor i arteve. (Aneksi 10), Planit Strategjik 2023-2026 (Aneksi 11) dhe Planit Strategjik 2023-2026 (Aneksi 12) të Fakultetit MTHM. Ky program është zhvilluar me një qasje bashkëkohore që e bën atë të krahasueshëm me kurrikulat e universiteteve të njohura ndërkombëtare (Aneksi 1,2,3). Misioni i këtij programi është të pajisë studentët me aftësi dhe njohuri që përputhen me nevojat e tregut të punës, të bëjnë lider në të ardhmën në fushën e Menaxhimit në Turizëm dhe Hoteleri, pse jo dhe për krijimin e politikave për strategji të turizmit që do të shërbejë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë. Ky program është në linjë të plotë me Misionin e Universitetit “Haxhi Zeka”, Misionin e fakultetit MTHM, në linjë të plotë me prioritetet strategjike, respektivisht me shtyllen e shtatë të prioritetëve nga Planit Strategjik 2023 – 2026 që është “Ndërmarrësia” dhe që përpjekjet maksimale janë të orientuara për konkretizimin dhe inkorporimin e punës teorike me shkathtësitë praktike të studentëve ashtu si edhe parashihet në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë, respektivisht niveli 6 i studimeve sipas Bolonjës. Në secilin hap të hartimit të këtij programi, vëmendje e veçantë i është kushtuar hulumtimeve të tregut të realizuara nga organizata të ndryshme që dëshmojnë se aftësitë
--	---

	menaxhuese të biznesit janë mjaft të kërkuara në tregun e punës. Po ashtu, këto aftësi menaxhuese parashihen edhe në dokumentin relevant (shih: Skills 2020 Kosovo, https://www.etf.europa.eu/en), si dhe bordit industrial të fakultetit MTHM, të cila dëshmojnë se aftësitë menaxhuese janë mjaft të kërkuara në tregun e punës (Takimet me bordin industrial të Fakultetit MTHM). Pra, është një program studimor bashkëkohor i ofruar në gjuhën shqipe dhe atë boshnjake, që përgatit të rinjtë me mendësi ndërmarrëse /menaxheriale dhe i aftëson ata për drejtëuar/menaxhuar një biznes që është mëse i nevojshëm për zhvillimin ekonomik të vendit.
Rezultatet e pritshme të të nxënit:	Rezultatet e të nxënit të programit të studimit: Njohuritë dhe të kuptuarit Studenti, gjatë studimeve, fiton: • Njohuri gjithëpërfshirëse dhe një kuptim bazë të fushës së Menaxhimit të Turizmit dhe Hotelerisë; • Njohuri për krijimin dhe menaxhimin e ofertave dhe paketave turistike, duke përdorur njohuritë e fituara për të zhvilluar produkte dhe shërbime që i përmbushin kërkesat e tregut; • Aftësi në planifikimin strategjik dhe menaxhimin e projekteve në sektorin e turizmit dhe hotelerisë, përfshirë zhvillimin e planeve dhe strategjive për rritjen dhe zhvillimin e bizneseve; • Të kuptuarit e teknologjive moderne dhe sistemet e menaxhimit në sektorin e turizmit dhe hotelerisë, duke përdorur mjete dhe software për të optimizuar operacionet dhe shërbimet; • Njohuri për menaxhimin financiar të bizneseve turistike dhe hoteliere, përfshirë planifikimin e buxheteve, analizën e performancës ekonomike dhe menaxhimin e kostove; • Njohuri për krijimin e inovacioneve dhe përmirësimin e shërbimeve dhe ofertave në sektorin e turizmit dhe hotelerisë, duke ndihmuar në zhvillimin dhe rritjen e industrisë përmes ideve dhe praktikave të reja. Zbatimi i njohurive dhe të kuptuarit: Studenti: • Zhvillon dhe zbaton strategji efektive për menaxhimin e operacioneve turistike dhe hoteliere, duke përdorur njohuritë e fituara gjatë studimeve; • Analizon dhe interpreton trendet e tregut dhe kërkesat e klientëve për të krijuar dhe menaxhuar oferta dhe shërbime turistike që i përmbushin ato;

	• Implementon sisteme të menaxhimit të cilësisë për të siguruar që shërbimet turistike dhe hoteliere janë në përputhje me standardet e larta dhe për të përmirësuar përvojën e klientëve; • Zbaton njohuritë e fituara për menaxhimin e burimeve njërëzore për të rekrutuar, trajnuar dhe motivuar stafin, duke ndihmuar në krijimin e një ambienti pozitiv dhe produktiv; • Aplikon teknologjitë bashkëkohore për të optimizuar proceset e rezervimeve dhe menaxhimin e operacioneve në sektorin e turizmit dhe hotelerisë; • Zbaton praktika të zhvillimit të qëndrueshëm në menaxhimin e aktiviteteve dhe destinacioneve turistike për të minimizuar ndikimet negative në mjedis dhe shoqëri; • Krijon dhe implementon iniciativa inovative që përmirësojnë shërbimet dhe ofertat në sektorin e turizmit dhe hotelerisë, duke rritur konkurrencën dhe kënaqësinë e klientëve. -
Procedurat e mësimdhënies:	Në tregun në tkurrje të arsimit të lartë në Kosovë e më gjerë do të mbijetojnë vetëm ato institucione që i lexojnë, i kuptojnë dhe reagojnë me kohë ndaj trendëve të reja. Qasja tradicionale dhe një dimensionale në ofrimin e shërbimeve të arsimit të lartë, thjeshtë nuk është më e qëndrueshme. Studentët e FMTHM, përkatësisht të programit Menaxhment dhe Turizëm dhe Hoteleri (Bsc) në të dyja gjuhët në përgjigje ndaj diversifikimit dhe kompleksitetit të shtuar të kërkesave të kohës së re, koncepti i studimeve të integruara në UHZ u jep mundësi studentëve të vetëdizajnojnë diplomën, duke zgjedhur lëndë të cilat ata i konsiderojnë të përshtatshme për karrierën e tyre të ardhshme; ofron rrugë më fleksibile të studimit; nxit autonominë dhe vendimmarrjen në zhvillimin personal të studentit (studimi; si dhe zgjeron përvojën akademike e shkencore përtej fushës së ngushtë të studimeve për të ndërtuar kompetencat e duhura për të ardhmen e tij profesionale. Për këtë arsye në politikat dhe planet e tij zhvillimore Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë është përcaktuar për zhvillimin dhe zbatimin e konceptit të studimeve të integruara. Studentët e FMTHM, përkatësisht të programit Bachelor ne Menaxhim ne Turizëm dhe Hoteleri në përgjigje ndaj diversifikimit dhe kompleksitetit të shtuar të kërkesave të kohës së re, koncepti i studimeve të integruara në UHZ u jep mundësi studentëve të vetëdizajnojnë diplomën, duke zgjedhur lëndë të cilat ata i konsiderojnë të përshtatshme për karrierën e tyre të ardhshme; ofron rrugë më fleksibile të studimit; nxit autonominë dhe vendimmarrjen në zhvillimin personal të studentit (studimi; si dhe zgjeron përvojën akademike e shkencore përtej fushës së ngushtë të studimeve për të ndërtuar kompetencat e duhura për të ardhmen e tij profesionale.

	Mësimdhënia është e organizuar në një formë të rregullt (me kohë të plotë) dhe përfshin një sërë aktivitete të planifikuara për të arritur objektivat e lëndëve dhe programit në tërësi. Këto aktivitete përfshijnë ligjërata, punë praktike, ushtrime teorike dhe praktike, seminare, kërkime shkencore, mentorim të studentëve dhe aktivitete të orientuara nga profesionistët e industrisë turistike. Çdo program studimi përfundon me një tezë diplome. Mësimdhënia organizohet në bazë të kësaj metodologjie: - Analiza të rasteve të studimit dhe shembuj nga praktika e bizneseve vendore dhe ndërkombëtare; - Diskutime dhe komunikim i hapur pedagog – student; - Ushtrime me shembuj konkretë nga fusha të ndryshme të ekonomisë; - Detyra që prezantohen dhe diskutohen nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor nën frymën e një bashkëveprimi produktiv dhe nën kushtet e një ambienti të favorshëm mësimi; - Ligjërata inter-aktive dhe prezantime në “Power Point” ose “Prezzi”;
Procedurat dhe llojet e vlerësimit të përdorura (notimi i studentëve);	Sipas nenit 104, 105, 106 të Statutit të UHZ, vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet me anë të testimit me shkrim dhe me gojë. Pjesa e vlerësimit dhe notimit të studentëve varet nga lënda dhe kriteret e përdorura në mënyrë individuale nga mësimdhënësi i lëndës. Studenti vlerësohet gjatë gjithë semestrit përmes testeve, punimeve seminarëve, pjesëmarrjeve në projekte, konferenca shkencore, etj. Metodat e vlerësimit përcaktohen në syllabuse të secilës lëndë mësimore veç e veç në kuadër të programit, Një shembull vlerësimi është si më poshtë: Pjesëmarrja aktive në mësim..... 10 % Detyrat, ushtrimet..... 10 % Testi i parë..... 20 % Testi i dytë.....20 % Provimi përfundimtar..... 40 % Total 100% Gjersa, një shembull i kriterit të notimit është si në vijim: 0-50.99%(5) 51-60.99%(6) 61-70.99%(7) 71-80.99%(8) 81-90.99%(9) 91-100%(10)
Modulet /Lëndët (titujt):	Viti I 1.Hyrje në turizëm dhe hotelieri 2.Matematikë

	3.Menaxhimi në turizëm dhe hoteliere 4.Shkrimi akademik 5.Gjuhë e huaj (Gjuhë Angleze I, Gjuhë Gjermane I) 6.Statistikë 7.Hyrje në ekonomi 8.Marketingu në turizëm dhe hotelieri 9.Teknologji e informacionit 10.Gjuhë e huaj (Gjuhë Angleze II, Gjuhë Gjermane II) Viti II 11.Hyrje në metodologjinë e kërkimit 12.Bazat e kontabilitetit 13.Burimet njërzore dhe zhvillimi profesional 14.Menaxhim i ushqimit dhe pijeve 15.Sistemet e rezervimit në hotele 16.Transporti në turizëm 17.Sistemet e rezervimit në agjencione turistike 18.Planifikimi dhe zhvillimi i turizmit 19.Gjeografia turistike 20.Trashëgimia kulturore në turizëm 21.Ekologjia 22.Ndërmarrësi 23.Shërbimi i klientit në hotel dhe agjencion turistik 24.Menaxhimi i mbeturinave në turizëm Viti III 25.Mësim praktik dhe zhvillimi i karrierës 26.E drejtë në turizëm dhe hotelieri 27.Menaxhimi dhe organizimi i eventeve 28.Industria e turizmit 29.Turizmi i qëndrueshëm 30.Hulumtimi i tregut turistik 31.Trendet bashkëkohore në turizëm dhe hotelieri 32.Menaxhimi i cilësisë 33.Produkti turistik 34.Tema e diplomës 35.Menaxhimi i destinacioneve turistike 36.Agjencionet turistike 37.Turizmi ndërkombëtar 38.Menaxhimi dhe mbrojtja e natyrës (Pejsazhet natyrore)
Numri i vendeve të studimit:	80 në gjuhë shqipe 30 në gjuhë boshnjake
Udhëheqës i drejtimit/programit të studimit:	Prof.Dr.Bedri Millaku Prof. ass. Dr. Anela Džogović

	Prof. ass. Dr. Hajrija Škrijelj Prof. ass. Dr. Merita Begolli Dauti
Personeli i përhershëm shkencor/artistik: (Numri sipas kategorive të personelit)	5 profesorë të rregulltë, 6 profesorë të asocuar, 7 profesorë asistent 2 dhe 1 asistentë.
Taksat e studimit:	Studimet janë falas Vërejtje: Në rast kur përsëritet vitit, bëhet pagesa sipas Udhëzimit Administrativ MASHTI Nr.09/2021.
Mundësitë e punësimit pas diplomimit:	- Spektori privat - Menaxher apo asistent menaxher në kompani private, në Turizëm, Hotelieri - Koordinator projektsh në Turizëm, Hotelieri - Sipërmarrje dhe start-up - Themelues i një biznesi të ri (sipërmarrës), në Turizëm, Hotelieri - Menaxher zhvillimi biznesi në start-up, në Turizëm, Hotelieri - Menaxher produkti apo inovacioni , në Turizëm, Hotelieri - Konsulent për rritje në Turizëm, Hotelieri - Konsulentë dhe analiza biznesi ne turizëm - Konsulent biznesi apo strategjie, në Turizëm, Hotelieri - Analist të dhënash apo tregu ne Turizëm, Hotelieri - Arsimin parauniversitar dhe universitar - Mësues i lëndëve ekonomike në shkolla të mesme (pas trajnimeve shtesë), në Turizëm, Hotelieri - Asistent mësimdhënieje apo kërkimi në universitet
Emri i institucionit:	Universiteti Haxhi Zeka
Fakulteti/Departamenti:	Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis
Kampusi qendrorë apo i degës:	Kampusi qendror/ Main Campus
Specifikoni për cilin kampus jeni duke aplikuar:	Click or tap here to enter text.
Emri i programit të studimit:	MENAXHIM NË TURIZËM DHE HOTELERI
Personi udhëheqës i programit:	Prof.dr.Bedri Millaku
Akreditim/Riakreditim:	Akreditim/ Accreditation

Niveli i kualifikimit sipas KKK:	ISCED 7
Diploma akademike apo emërtimi i diplomës:	“MENAXHIM NË TURIZËM DHE HOTELERI” (BSC)
ECTS:	180
Specializimet / Koncentrimet:	Click or tap here to enter text.
Kodi i Zonës së Subjektit Erasmus (ESAC):	04.7 04.0
Forma e studimeve:	Të rregullta Shqip / Boshnjake / Full Time
Kohëzgjatja minimale e studimeve:	3 vite akademike
Numri i vendeve të studimit / Kuota:	80 Gjuhë Shqipe/ 30 Gjuhë Boshnjake
Personeli i përhershëm shkencor/artistik për programin e studimit (së paku 3 PhD):	Prof.Dr.Bedri Millaku Prof. ass. Dr. Anela Džogović Prof. ass. Dr. Hajrija Škrijelj Prof. ass. Dr. Merita Begolli Dauti